

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2024, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka përmbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve, objekt i ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Konkretisht është konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe aktiviteteve të tjera konsultative dhe miratuar projektaktet si vijon:

- Projektligji “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jopronarë në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore”, (miratuar).
- Projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, (miratuar).
- Projektvendimi “Për miratimin e planit të menaxhimit të parkut arkeologjik Bylis (qytetet antike të Bylisit dhe Klosit -2024-2029).

Realizimi i procesit të konsultimit publik për vitin 2024 është 100%. Procesi i Konsultimit Publik krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, format e përzgjedhura të konsultimit kanë rezultuar efektive duke mundur mbledhjen dhe reflektimin e reagimeve të palëve të interesit në draftin përfundimtar më qëllim krijimin e projektakteve të gjithë pranuar dhe që reflekton interesin e publikut. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik mbetet sfida për t’u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë në të ardhmen.

2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2024

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për vitin 2024 është 77 akte.

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Për gjatë vitit 2024, i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik 10 projektakte nga të cilat janë miratuar projektaktet si;

1. Projektligji “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesve faktikë jopronarë në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore”.
2. Projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”.

3. Projektvendimi “Për miratimin e planit të menaxhimit të parkut arkeologjik Bylis (qytetet antike të Bylisit dhe Klosit -2024-2029).

Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.1.3 Sa ligje me raport VNR-je janë konsultuar?

- Projektligji “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jo pronarë në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore”.
- Projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, të cilët i janë nënshtruar procesit të konsultimit gjatë periudhës korrik - dhjetor 2024, janë shoqëruar nga raporti përkatës VNR.

2.1.4 Për sa akte në a) Program Analitik, PKIE, Dokumente strategjik janë përdorur kriteret përjashtuese nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse do të kishte të tilla)

Kriteret përjashtuese sipas dispozitës së nenit 4 të ligjit Nr.146\2014“Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, janë aplikuar për 36 akte të parashikuara në vendimin nr.790/2023 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”.

Kriteret përjashtuese nuk janë aplikuar për 2 projektaktet e parashikuara në PKIE dhe në dokumentet strategjike kombëtar dhe sektorial si; Projektligji "Për markat tregtare" Për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë konsultimi i të cilave është realizuar në vitin 2023.

2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, rregullore ministrorë, etj.)?

Aktet objekt i konsultimit publik gjatë vitit 2024, kanë qenë 2 projektligje, dhe 1 projektvendim.

2.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar?

Situata mbetet njëloj si vitin e kaluar, duke mbajtur të njëjtin trend pozitiv për përfshirjen e aktorëve. Në konsultimin e këtyre akteve janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh, në disa platforma si RENjK, email, takime publike dhe sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose dhe pse. Hapat e procesit janë respektuar rigorozisht: Projektligjet janë publikuar në sistemin e informacionit të qeverisë (RENjKP), është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit dhe janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre nëpërmjet raporteve individuale, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1 *Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.)*

Për të gjithë projektaktet e konsultuara janë përdorur metoda të ndryshme konsultimi: tryeza e rrumbullakët, e – mail, korrespondencë zyrtare, takime online dhe RENjKP.

Projektligji “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jopronarë në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore”, është përdorur metoda e konsultimit publik nëpërmjet RENjKP.

Projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, është përdorur metoda e konsultimit publik nëpërmjet RENjKP. Projektvendimi “Për miratimin e planit të menaxhimit të parkut arkeologjik Bylis (qytetet antike të Bylisit dhe Klosit -2024-2029) ”, është përdorur metoda e konsultimit publik nëpërmjet RENjKP dhe takim publike.

2.2.2 *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda që gjeneroi më shumë komente kanë qenë takimet online, e pasuar nga email-et dhe ajo më pak e përdorura është RENjKP.

2.2.3 *A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Nuk ka pasur konsultime paraprake në fazën e hershme të hartimit, konsultimet janë zhvilluar pasi draftet janë hartuar.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?*

Të gjitha projektaktet janë konsultuar për më shumë se 20 ditë.

2.3.2 *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për këtë periudhë ishte 4 katër) muaj. Kjo përlllogaritje është bërë duke pasur në vëmendje kohën (numrin e muajve) gjatë të cilës ka filluar puna për identifikimin e grupeve të interesit, hartimin e draftit, publikimin e tij në RENJK, zhvillimin e takimeve konsultative, marrjen dhe vlerësimin e komenteve dhe përgatitjen e një drafti final për projektaktin.

2.3.3 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Në krahasim me vitin e kaluar situata ka pasur një rritje të dukshme të kohëzgjatjes së procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut të jetë në ngritje. Një nga proceset që mund të përdoret

me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të kësaj situate është zhvillimi sesioneve të ndryshme njohëse me portalin e RENJK me aktorë të ndryshëm.

2.4. Palët e interesit të përfshira

2.4.1 *Sa palë interesi të jashtme morën pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve gjatë vitit? Sa eksperte ishin në tryeza?*

Projektligji “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jopronarë në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” u diskutua me pjesëmarrje të grupeve të interesit si; Sotirag Hroni, Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Arben Pëllumbi, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Përfaqësues i Lartë i Ambasadës Britanike në Tiranë. Edwin Zhllima, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Përfaqësues nga Paneli i Qytetarëve për turizmin rural dhe malor, Evelina Azizaj, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural. Përfaqësues të institucioneve qendrore si AAMV, AZHBR, AREB-eve etj, 61 bashkive të vendit, organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal, komuniteteve lokale, sipërmarrësve të turizmit, ekspertëve dhe qytetarëve, komunitetit të donatorëve, medias etj.

Projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore” u konsultuan nëpërmjet RENKJP nga ku rezultuan 3 komente nga kategoria qytetarë.

Projektvendimi “Për miratimin e planit të menaxhimit të parkut arkeologjik Bylis (qytetet antike të Bylisit dhe Klosit -2024-2029) është hartuar me kontributet e disa autorëve, specialistë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë të referuar në faqen 2 të draftit të rishikuar të PM, me ndihmën teknike të: Universiteti i Bolonjës, Rajoni Emilia-Romagna, Instituti i Arkeologjisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe inovacionit, Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. Në procesin e konsultimit morën pjesë rreth 100 grupe interesi, ekspertë të fushës, qytetarë dhe institucione dhe organizata civile të cilat ndikohen nga ky projektvendim si;

Autorë ndërkombëtarë dhe kombëtar, ekspertë të fushës; Mbështetje teknike nga Universiteti i Bolonjës, Rajoni Emilia-Romagna; Instituti i Arkeologjisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore; Universitetet dhe komuniteti akademik; Bashkitë; Komuniteti Lokal; Institucionet shtetërore; Organizata civile të fushës; Qytetarët nëpërmjet RENJKP.

Në hartimin e këtij Plani kanë kontribuar gjithashtu Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni-Bylis, Bashkia Mallakastër si dhe aktorë të shumtë të interesuar, institucione qendrore dhe lokale, dhe komuniteti lokal.

2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individual, OSHC, kompani, etj.)*

Për projektligjin “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jopronarë në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” dhe Projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: 1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; 3) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe

personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

Për sa i përket projektvendimit “Për miratimin e planit të menaxhimit të parkut arkeologjik Bylis (qytetet antike të Bylisit dhe Klosit -2024-2029) kanë qënë të përfshirë ekspertë, qytetarë , institucione shtetërore OSHC.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të bëra për projekt-akte në vitin e caktuar?

Në procesin e konsultimit morën pjesë rreth 100 grupe interesi, ekspertë të fushës, qytetarë dhe institucione dhe organizata civile. Gjatë procesit të konsultimit publik u zhvilluan dy dëgjesa. Dëgjesa e parë publike u zhvillua në Parkun Arkeologjik të Bylisit në datën 8.04.2024. Në këtë dëgjese morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Institutit Arkeologji/Akademia e Shkencave, specialistë arkeologë të njohur, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë, Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Bashkisë Mallakastër Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis (ZAKPA), përfaqësues nga komuniteti, biznesi lokal, dhe Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim. Dëgjesa e dytë u mbajt në Tiranë në datë 7.05.2024 në të cilën morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim, Akademia e Shkencave, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Universiteti i Tiranës (Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore), Delegacioni i BE në Shqipëri, Media-s, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe ekspertë të trashëgimisë kulturore.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Projektligji “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jopronarë në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore”, u diskutua me pjesëmarrje të grupeve të interesit si; Sotirag Hroni, Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Arben Pëllumbi, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Përfaqësues i Lartë i Ambasadës Britanike në Tiranë. Edvin Zhllima, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Përfaqësues nga Paneli i Qytetarëve për turizmin rural dhe malor, Evelina Azizaj, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural. Përfaqësues të institucioneve qendrore si AAMV, AZHBR, AREB-eve etj, 61 bashkive të vendit, organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal, komuniteteve lokale, sipërmarrësve të turizmit, ekspertëve dhe qytetarëve, komunitetit të donatorëve, medias etj.

Projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, nuk ka pasur ekspertë të jashtëm të përfshirë në hartimin e tyre komentet janë dhënë nga kategoria qytetarë në RENKJ.

Për sa i përket projektvendimit “Për miratimin e planit të menaxhimit të parkut arkeologjik Bylis (qytetet antike të Bylisit dhe Klosit -2024-2029) kanë qënë të përfshirë ekspertë, qytetarë , institucione shtetërore OSHC.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur në përmirësim. Kjo gjë

konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga MEKI. Gjithashtu, edhe një tjetër tregues rezulton dhe nga monitorimi i portalit të Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Numri total i komenteve të marra është 14.

2.5.2 *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore” 3 komentet e dhëna u refuzuan me shpjegimin përkatës në raport.

Për projektvendimin “Për miratimin e planit të menaxhimit të parkut arkeologjik Bylis (qytetet antike të Bylisit dhe Klosit -2024-2029) u dhanë 11 komente nga të cilat 9 u pranuan, 1 u refuzua dhe 1 u pranua pjesërisht.

2.5.3 *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Situata mbetet njëloj si për vitin e kaluar, duke mbajtur të njëjtin trend pozitiv për përfshirjen e komenteve nga aktorët.

Pozitive është se numri më i lartë i komenteve ka ardhur nga profesionistët e fushës kryesisht në fushën e trashëgimisë kulturore.

2.5.4 *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Asnjë raport VNR nuk është ndryshuar apo përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik.

2.6. Rezultatet e raporteve të konsultimeve

2.6.1 *Sa raporte konsultimesh publikoi ministria?*

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka hartuar dhe publikuar në portalin e regjistrisë elektronike për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK) raportin individual të për të tre projektaktet.

2.6.2 *Nëse disa nuk u botuan, cilat janë arsyet?*

Për vitin 2024 MEKI ka hartuar raportin e konsultimit për projektaktet për të cilat ishte planifikuar procesi i konsultimit publik, ku raportet janë publikuar në portalin e regjistrisë

elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK).

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve)

Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës është 8.

3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërfshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet qartësisht një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Me gjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projekt akteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik.